



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of Kosovo
Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



Në bazë të Nenit 38, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 04/L-063 për Hekurudhat e Kosovës,
Bordi i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave aprovon:

Rregullore Nr. 01/2014

Për modelin e deklaratës së konformitetit për llojin e autorizuar të mjetit
hekurudhor

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO	
AUTORITETI RREGULLATIV I HEKURUDHAVE	
REGULATIVNI AUTORITETI ŽELEZNICA	
RAILWAY REGULATORY AUTHORITY	
DEP/SEK. DEP/SEK. DEP/SEK.	NR PROT: BR. PROT: NR PROT:
01	31
NUMRI I FAGEVE BROJ STRANA NR OF PAGES	DD.MM.YVVV: DD.MM.GGGG: DD.MM.YYYY:
4	10/05/2014
PRISHTINË / A	

Rr. Rrustem Statovci nr.29
Prishtinë, Kosovë
Tel:+381 38 22 00 40
Fax:+381 38 22 33 40
Web:www.arh-ks.org

Kuvendi i Kosovës
Skupština Kosova
Assembly of Kosovo

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i Rregullores është që të paraqes procedurat për modelin e Deklaratës së konformitetit për llojin e autorizuar të mjetit lëvizës hekurudhor, duke marr parasysh Ligjin për Hekurudhat e Kosovës neni 110 (3) dhe Direktivën 2008/57/EC për Interoperabilitet ,nenit 26 (3).

Neni 2

Fushëveprimi

Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen për të gjithë Operatoret Hekurudhorë dhe Menaxherët e Infrastrukturës në Republikën e Kosovës të cilët kanë për qëllim autorizimin për futje në shërbim të mjeteve të reja hekurudhore, lloji i të cilave është i autorizuar në një shtet anëtar të BE-së dhe në shtetet tjera me të cilat Kosova ka marrëveshje të veçanta.

Neni 3

Agjencia Evropiane e Hekurudhave

Agjencia Evropiane e Hekurudhave (ERA) ka lëshuar rekomandimin, më datën 30 Qershor 2010, mbi modelin e deklaratës së konformitetit për llojin e autorizuar të mjetit lëvizës, model i cili ka hyr në fuqi me Rregulloren e BE-së Nr. 201/2011. Në mënyrë që modeli i Deklaratës së Konformitetit i lëshuar nga ARH të jetë konform legjislacionit të BE-së, kjo deklaratë do të jetë konform Rregullores së BE-së 201/2011.

Neni 4

Organi kompetent

ARH-ja përgjegjës për Interoperabilitet paraqet modelin e deklaratës së konformitetit duke u bazuar në Ligjin për Hekurudhat e Kosovës, neni 110 (7), Direktivën 2008/57/EC, neni 26 (4) dhe Rregulloren 201/2011/ EU.

Neni 5
Përmbajtja e deklaratës

Shtojca për deklaratën e konformitetit të llojit duhet të sigurojë dëshmi mbi përfundimin e procedurave përkatëse për verifikim, në përputhje me legjislacionin e Evropian në fuqi dhe rregullave të njohura Kombëtare, të shënoj referencat e Direktivave, Specifikimet Teknike për Interoperabilitet, Rregullat Kombëtare dhe dispozitat e tjera. Ai lloj Autorizimi, i cili është identifikuar me numrin identifikues Evropian, duhet të ofroj informacione mbi të gjitha kërkesat ligjore mbi bazën e të cilit është dhënë ky lloj autorizimi në një shtet anëtar të BE-së dhe në shtetet tjera me të cilat Kosova ka marrëveshje të veçanta.

Neni 6
Modeli

Modeli i deklaratës së konformitetit për llojin e autorizuar të mjeteve lëvizëse i cekur në Ligjin për hekurudhat e Kosovës, nenin 110 (7) dhe nenin 26 (4) të Direktivës 2008/57/EC është përcaktuar në Shtojcën e kësaj Rregulloreje.

Neni 7
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Halit Gara,
Kryetar i Bordit
Prishtinë 03/03/2014

SHTOJCË

MODELI I DEKLARATËS SË KONFORMITETIT PËR LLOJIN E AUTORIZUAR TË MJETIT LËVIZËS

Ne,

Aplikuesi ⁽¹⁾

[Emri Biznesit]
[Adresa e plotë]

Përfaqësuesi i Autorizuar

[Emri i Biznesit]
[Adresa e plotë]

E aplikantit

[Emri i Biznesit]
[Adresa e plotë]

Deklaroj nën përgjegjësinë tonë që mjete lëvizës [Numri Evropian i mjetit lëvizës] ⁽²⁾, me të cilin ka të bëjë kjo deklaratë

- përputhet me llojin e mjetit lëvizës [ERATV identifikimi i llojit të mjetit] të autorizuar në këto Shtete:

[Shteti 1] nën autorizimin Nr. [EIN e llojit të autorizimit në MS 1]

[Shtet 2] nën autorizimin Nr. [EIN e llojit të autorizimit në MS 2]

... (t'u dëshmoj të gjitha shtetet se ku është autorizuar ky mjet lëvizës)

-përputhet me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian, Specifikimet përkatëse Teknike për Interoperabilitet dhe rregullat e aplikueshme kombëtare, siç tregohet në shtojcat e kësaj deklarate,

- i'u është nënshtruar të gjitha procedurave të nevojshme të verifikimit për krijimin e kësaj deklarate

Lista e shtojcave ⁽³⁾

[Titujt e shtojcave]

Nënshkruar për dhe në emër të [emri i aplikantit]

E përfunduar në [vendi], [data DD / MM / VVVV]

[emri, funksioni] [nënshkrimi]

Fusha të rezervuara për ARH:
EVN e alokuar në mjetet lëvizëse: [EVN]

⁽¹⁾ Aplikanti mund të jetë subjekt kontraktues, prodhues ose përfaqësuesi i autorizuar i tyre në Bashkimin Evropian.

⁽²⁾ Nëse në momentin e krijimit të kësaj deklarate mjetit ende nuk i'u është vënë një numër Evropian për mjetin lëvizës (EVN), mjete lëvizës duhet të identifikohet me një sistem tjetër identifikimi miratuar nga aplikanti dhe ARH-ja. Në këtë rast, kur një EVN i'u është caktuar mjete lëvizës, ARH duhet të plotësoj fushën e rezervuar për këtë qëllim.

⁽³⁾ Shtojcat duhet të përfshijnë kopjet e dokumenteve që ofrojnë dëshmi mbi përfundimin e procedurave përkatëse të verifikimit në përputhje me legjislacionin e Bashkimit Evropian (deklaratat EC të verifikimit) dhe rregullat kombëtare.